



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 18.12.2018	Numri i seancës për këtë çështje: 1
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit		
Emri i subjektit të rivlerësimit	Elaida Goxhi		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Drejtuuese e Prokurorisë, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca u shty për dhënien e vendimit për në datë 20 Dhjetor, ora 10: 00, dhe trupi gjyqës nuk paraqiti asnjë arsye për këtë shtyrje.		
lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmblodhur	Vendimi nuk u shpall në përfundim të seancës dëgjimore, në kundërshtim me nenin 55 pika 6 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve".		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Trupi gjyqës (emrat)	Xhensila Pine, kryesuese, Suela Zhegu, relatore, dhe Brunilda Bektashi, anëtare.		
Monitoruesit nderkombetare (emrat)	Znj. Marie Tuma		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Subjekti u mbrojt personalisht përpara Komisionit.		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	10 anëtarë nga publiku. Seanca u monitorua edhe nga një vëzhgues i Avokatit të Popullit.		
Media e pranishme:	Në sallën ku u zhvillua seanca dëgjimore u vu re një numër i vogël i përfaqësuesve të medias. Kështu, seanca u monitorua nga përfaqësues të medias së shkruar, (BIRN, dhe Gazeta Shekulli) si dhe u vërejtën operatorë të medias që kryenin video regjistrimin e çeljes së seancës dëgjimore.		
C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po	Nesë po, si u justifikua ai?	Nesë po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	Rivlerësimi i këtij subjekti u krye për të tri kriteret e parashikuara nga ligji.		
D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	Kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	Në lidhje me këtë kriter, relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e vlerësimit të institucionit ndihmës, ILDKPKI, i cili ka konstatuar pozitivisht lidhur me deklarin dhe ligjshmërinë e të ardhurave që justifikojnë pasuritë e subjektit, si dhe mungesën e situatës së konfliktit të interesit.	ILDKPKI	Barra e provës u kalua sipas ligjit
	Në përfundim të hetimit të saj KPK ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit disponon pasuritë si më poshtë: 1. Investim në bono thesari në vlerën 2.2 milion lekë. Lidhur me këtë pasuri KPK konstatoi se deklarimi i subjektit lidhur me burimin nga pagat ishte i vërtetë. 2. Subjekti jeton në apartamentin e prindërve të saj me sipërfaqe 96 m2, në Tiranë, të cilin ata e kanë përfutur nga privatizimi në vitin 1993. Si përfundim KPK konstatoi se vlera totale e likuiditeteve të këtij subjekti të rivlerësimit është 2.7 milion Lekë, të cilat justifikohen me të ardhurat nga paga ndër vite në bazë të analizës financiare.	Relatori	
	n/a	Mbrojtja	
	U shpreh dakord me konstatimet e hetimit të KPK.	Subjekti	

	Asnjë	Ankesa nga publiku	
	Asnjë	ONM	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës relatorja u shpreh se në bazë të ligjit, DSIK ka paraqitur raportin përkatës ku ka konstatuar përshtatshmërinë e këtij subjekti për të vazhduar detyrën.	DSIK	Barra e provës u kalua sipas ligjit
	Pas hetimit dhe verifikimeve të saj KPK ka konfirmuar të njëjtën gjë lidhur me pastërtinë e figurës së këtij subjekti	Relatori	
	n/a	Mbrojtja	
	U shpreh dakord me konstatimet e hetimit të KPK.	Subjekti	
	Asnjë	Ankesa nga publiku	
	Asnjë	ONM	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Relatorja shpjegoi se njësia përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme i ka paraqitur KPK raportin e hollësishëm të aftësive profesionale dhe etike të këtij subjekti, në bazë të ligjit, i cili ka konstatuar pozitivisht	Prokuroria e Përgjithshme	Barra e provës u kalua sipas ligjit
	Relatori u shpreh se përveç raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, KPK ka zhvilluar hetimin e saj, bazuar edhe në të dhëna të tjera, përfshirë arkivin e këtij institucioni si dhe ankesat e paraqitura nga publiku, duke e vënë në pikëpyetje vlerësimin për këtë kriter.	Relatori	
	Relatorja u shpreh se në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale ka pasur 3 ankesa nga publiku. Konkretisht këto ankesa kishin të bënin me 3 raste të zvarritjes së hetimeve, moskryerjes së veprimeve hetimore në shkëlqje të detyrave dhe afateve ligjore. Në një prej rasteve, ankuesi ka deklaruar se subjekti e ka mbajtur dosjen “në sirtar” për 2 vjet.	Ankesa nga publiku	
	Në lidhje me ankesat nga publiku, subjekti u shpreh se për të tre çështjet ku ato referohen, ajo, në cilësinë e prokurores dhe drejtueses së prokurorisë ka kryer të gjitha hetimet dhe ndërmarrë të gjitha hapat procedurale sipas ligjit. Lidhur me çështjen e “mbajtur në sirtar”, ajo u shpreh se çështjen e ka pasur në hetim për një vit, dhe kjo kohëzgjatje ka ardhur si pasojë e mbingarkesës.	Subjekti, etj..	
	Lidhur me këtë kriter, vëzhguesja Marie Tuma e pyeti subjektin e rivlerësimit si cila ka qenë arsyeja që ajo e ka mbajtur çështjen nën hetim për një vit, siç deklaroi në seancë. Subjekti u përgjigj se kjo kohëzgjatje është dashur për të marrë vendime për veprimet hetimore të përcaktuara nga gjykata e Apelit Vlorë, pasi ka qenë një çështje e pushuar dhe e kthyer për hapje hetimi nga gjykata, dhe për kryerjen e veprimeve hetimore nga oficeri i policisë gjyqësore.	ONM	
E.Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vetingut dhe përfaqësuesit të OMN, si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	<p>Parimi i publicitetit të gjykimit</p> <p>Gjatë diskutimit në seancën dëgjimore nuk doli e qartë se cili ishte konkluzioni përfundimtar i relatorit, lidhur me kriterin e aftësive profesionale, siç parashikon neni 44 i ligjit 84/2016, i cili parashikon se në bazë të raportit të inspektorëve, dhe informacione të tjera del me relacion të vlerësimit ku propozon se subjekti është përkatësisht “i aftë”, “me mangësi”, apo “i papërshtatshëm” dhe nëse provat e grumbulluara gjatë hetimit të KPK kishin arritur nivelin e provueshmërisë sipas nenit 52 të këtij ligji.</p> <p>Kishte vlerësuar KPK ankesat e ardhura nga publiku dhe nëse i kishte pranuar ato si provë sipas nenit 49 pika 1 shkronja “b” të ligjit 84/2016.</p> <p style="text-align: right;">Gjithashtu nuk doli e qartë se si i</p>		